



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 51, datë 28.02.2023

**PËR**  
**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 474,**  
**DATË 23.12.2017 “PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË**  
**BANORËVE PËRFITUES TË BANESAVE SOCIALE ME QERA, SEKSIONI III**  
**(STRUKTURË 1+1 DHE 2+1), SHKOZET, DURRËS”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet, që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 474, datë 23.12.2017 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të banorëve përfitues të banesave sociale me qira me Seksioni III më strukturë 1+1 dhe 2+1”, Shkozet, Durrës, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Komisioni i Strehimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të listës emërore të familjeve përfituese nga banesat sociale me qira me strukturë 1+1 dhe 2+1, Seksioni III, Shkozet, Durrës, miratuar me Vendimin e Këshillit

Bashkiak nr. 474, datë 23.12.2017, sipas listës bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi si më poshtë:

- a. Ndryshimin e emrit të qiramarrësit për shkak të ndarjes nga jeta të znj.Lorisa Kujtim Milla në znj.Uendi Enver Cana, në bazë të çertifikatës familjare datë 01.02.2022 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile si kryefamiljare, nuk kemi ndryshime të tjera në përbërjen familjare. Qiramarrësi përmbush të gjitha kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për të qënë përfitues.
  - b. Ndryshimin e emrit të qiramarrësit për shkak të ndarjes nga jeta të z.Rexhep Selim Kananaj në znj.Liri Azis Kananaj, në bazë të çertifikatës familjare datë 22.02.2023 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile si kryefamiljare, nuk kemi ndryshime të tjera në përbërjen familjare. Qiramarrësi përmbush të gjitha kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për të qënë përfitues.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 02.03.2023**

**"Për ndryshimin e VKB-së nr.474 datë 23.12.2017 "PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË BANORËVE PËRFITUES TË BANESAVE SOCIALE ME QERA, SEKSIONI III (STRUKTURË 1+1 DHE 2+1), SHKOZET DURRËS"**

Nr.	Emer Mbiemer	Seksioni	Kati	Hyrja	Sip.	Strukturra	VI e Qerase	Shënime (jeton me qera)
1	Lorisa Kujtim Milla(vdekur)	A1	4	1	69.65	1+1	7000	Uendi Enver Cana
2	Rexhep Selim Kanana(vdekur)	B2	4	4	70.5	1+1	7100	Liri Azis Kanana

Shënim :Kjo listë përbëhet nga 2 (dy) familje përfituese .





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 166/prot.

Durrës, më 13 03.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**



**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.51 datë 28.02.2023 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 474, datë 23.12.2017 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të banorëve përfitues të banesave sociale me qera, seksioni III (strukturë 1+1 dhe 2+1), Shkozet, Durrës”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI  
EMILJAN JANI**

